



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË
TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

Nr. _____ Prot.

Himarë, më ____ / ____ / 2026

SHTOJCË NR. 1, DATË 14/07/2026
PËR DISA NDRYSHIME NË DOKUMENTET E TENDERIT

Bazuar në nenin 75 (2) të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, i cili parashikon shprehimisht se “2. Autoriteti ose enti kontraktor, nga momenti i shpalljes së njoftimit të kontratës deri përpara mbarimit të afatit të fundit për dorëzimin e ofertave dhe për çfarëdolloj arsyeje, me nismën e vet ose me kërkesë të palëve të interesuara, mund të vendosë të bëjë ndryshime në dokumentet e tenderit përmes hartimit të një shtojce. Nëse ndryshimi i dokumenteve të tenderit bëhet në gjysmën e parë të afatit të pranimit të ofertave, autoriteti ose enti kontraktor mund të zgjasë afatin kohor të pritjes së ofertave. Nëse ndryshimi i dokumenteve të tenderit bëhet në gjysmën e dytë të afatit të pranimit të ofertave, autoriteti ose enti kontraktor zgjat afatin kohor për dorëzimin e ofertës me të paktën 10 ditë për procedurat mbi kufirin e lartë monetar dhe me të paktën 7 ditë për procedurat nën kufirin e lartë monetar”, me qëllim hartimin e disa ndryshimeve në shtojcën 5 “Specifikimet teknike” dhe shtojcën nr. 7 “Fomulari i kriterëve të përzgjedhjes/kualifikimit”, e-mail-in e zyrës së koordinimit të APP-së datë 10.07.2026, njësia e prokurimit kryen modifikimet e nevojshme në dokumentet e tenderit dhe i publikon ato në Sistemin e Prokurimit Elektronik, me qëllim informimin e të gjithë operatorëve ekonomikë të interesuar, si më poshtë vijon:

1. Pika 2.15 e Njoftimit të Kontratës ndryshon si më poshtë:

ISHTE:

Pranohen variantet:

Po ☐ Jo ☐

BËHET:

Pranohen variantet:

Po ☐ Jo ☒

2. Në shtojcën nr. 5 “Specifikimet teknike” bëhet ky sqarim:

”Për standartet ndërkombëtare do të pranohet dhe mundësia e paraqitjes së standartit SSH/UNI/DIN/EN/ISO mbi konformitetin e standardit evropian dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë”.

3. Në shtojcën nr. 7 “Fomulari i kriterëve të përzgjedhjes/kualifikimit”, pika 2.1.1 e përshtatshmërisë për të kryer veprimtarinë profesionale, ndryshon si më poshtë:

ISHTE:

2.1.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga organet kompetente, e cila duhet të përfshijë kategoritë e mëposhtme:

PUNIME TË PËRGJITHSHME NDËRTIMI

- NP-1 A – Punime gjurmimi në tokë;
- NP-4 A – Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvaj, metro, pista aeroportuale;
- NP-12 A – Punime të inxhinierisë së mjedisit.

PUNIME SPECIALE NDËRTIMI

- NS-18 A – Punime topogjeodezike.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë licencat profesionale sipas zërave të preventivit që, në bazë të marrëveshjes së bashkëpunimit, merr përsipër të realizojë.

Operatorët ekonomikë të huaj duhet të bëjnë ekuivalentimin e licencave profesionale që disponojnë, të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (ose ministrisë kompetente të kohës) në Republikën e Shqipërisë, referuar VKM-së nr. 42, datë 16.01.2008, “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”.

BËHET:

2.1.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga organet kompetente, e cila duhet të përfshijë kategoritë e mëposhtme:

PUNIME TË PËRGJITHSHME NDËRTIMI

- *NP-1 A – Punime gjurmimi në tokë;*
- *NP-4 A – Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvaj, metro, pista aeroportuale;*

PUNIME SPECIALE NDËRTIMI

- *NS-18 A – Punime topogjeodezike.*

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë licencat profesionale sipas zërave të preventivit që, në bazë të marrëveshjes së bashkëpunimit, merr përsipër të realizojë.

Operatorët ekonomikë të huaj duhet të bëjnë ekuivalentimin e licencave profesionale që disponojnë, të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (ose ministrisë kompetente të kohës) në Republikën e Shqipërisë, referuar VKM-së nr. 42, datë 16.01.2008, “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”.

4. Në shtojcën nr. 7 “Fomular i kriterëve të përzgjedhjes/kualifikimit”, pika 2.2.1 e kapacitetit ekonomik dhe financiar ndryshon si më poshtë:

ISHTE:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2023, 2024 dhe 2025, ku vlera e xhiros, për të paktën

një nga vitet e periudhës së kërkuar, duhet të jetë jo më e vogël se 39% e vlerës së fondit limit që prokurohet.

BËHET:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2023, 2024 dhe 2025, ku vlera e xhiros, për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar, duhet të jetë jo më e vogël se 39% e vlerës së fondit limit që prokurohet. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti kontraktor.

5. Në shtojcën nr. 7 “Fomular i kriterëve të përzgjedhjes/kualifikimit “Kriteret e veçanta të kualifikimit” pika 2.3.1 e kapacitetit teknik ndryshon si më poshtë:

ISHTE:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për:

- një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 29 % e vlerës së përllogaritur të kontratës dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.
 - punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se vlera limit e kontratës që prokurohet.
- Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.
- Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik, duhet të paraqiten vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së kryer.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, duhet të paraqiten vërtetime për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së kryer, e shoqëruar me fatura tatimore të deklaruara në organet tatimore si dhe me situacionet e punimeve dhe akt-kolaudimin.

BËHET:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për:

- një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 29 % e vlerës së përllogaritur të kontratës dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.
 - punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se 95 % e vlerës limit të kontratës që prokurohet.
- Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.
- Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik, duhet të paraqiten vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së kryer.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, duhet të paraqiten vërtetime për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra

e punës së kryer, e shoqëruar me fatura tatimore të deklaruara në organet tatimore si dhe me situacionet e punimeve dhe akt-kolaudimin.

6. Në shtojcën nr. 7 “Fomular i kriterëve të përzgjedhjes/kualifikimit “Kriteret e veçanta të kualifikimit” pika 2.3.2 e kapacitetit teknik ndryshon si më poshtë:

ISHTE:

2.3.2 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të disponojë personelin kryesor drejtues teknik, të përfshirë në licencën e shoqërisë dhe që figuron në listëpagesën e shoqërisë për muajin e fundit, si më poshtë:

- 1 (një) inxhinier ndërtimi;
- 1 (një) inxhinier topograf/gjeodet;
- 1 (një) inxhinier mjedisi;
- 1 (një) arkitekt.

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatori ekonomik duhet të paraqesë diplomë, kontratë pune, CV dhe librezë pune.

Disponimi i punonjësve të kërkuar do të dëshmohet nëpërmjet formularit përmbledhës të vetëdeklarimit.

Në zbatim të pikave 1 dhe 6 të nenit 26 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimeve të nenit 82 të LPP-së.

Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, të renditur i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të vetëdeklaruara, si dhe dokumenteve të tjera shoqëruese të ofertës të paraqitura në rrugë elektronike.

BËHET:

2.3.2 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të disponojë personelin kryesor drejtues teknik, të përfshirë në licencën e shoqërisë dhe që figuron në listëpagesën e shoqërisë për muajin e fundit, si më poshtë:

- 1 (një) inxhinier ndërtimi;
- 1 (një) inxhinier topograf/gjeodet;
- 1 (një) arkitekt.

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatori ekonomik duhet të paraqesë diplomë, kontratë pune, CV dhe librezë pune. Arkitekti mund të disponohet edhe me kontratë bashkëpunimi.

Disponimi i punonjësve të kërkuar do të dëshmohet nëpërmjet formularit përmbledhës të vetëdeklarimit.

Në zbatim të pikave 1 dhe 6 të nenit 26 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimeve të nenit 82 të LPP-së.

Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, të renditur i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të vetëdeklaruara, si dhe dokumenteve të tjera shoqëruese të ofertës të paraqitura në rrugë elektronike.

7. Në shtojcën nr. 7 “Fomular i kriterëve të përzgjedhjes/kualifikimit “Kriteret e veçanta të kualifikimit” pika 2.3.3 e kapacitetit teknik ndryshon si më poshtë:

ISHTE:

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të disponojë punonjës të specializuar/të kualifikuar, të pajisur me diplomë ose dëshmi përkatëse, të lëshuar nga institucione të akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, si dhe të figurojnë në listëpagesën e shoqërisë për muajin e fundit, si më poshtë:

- 2 (dy) betonues;
- 1 (një) pllakashtrues;
- 1 (një) shtrues asfalti;
- 1 (një) elektrikist;
- 1 (një) teknik ndërtimi;
- 1 (një) manovrator.

Disponimi i punonjësve të kërkuar do të dëshmohet nëpërmjet formularit përmbledhës të vetëdeklarimit. Për dokumentacionin provues zbatohen përcaktimet e nenit 26 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

BËHET:

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të disponojë punonjës të specializuar/të kualifikuar, të pajisur me diplomë ose dëshmi përkatëse, të lëshuar nga institucione të akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, si dhe të figurojnë në listëpagesën e shoqërisë për muajin e fundit, si më poshtë:

- 2 (dy) betonues;
- 1 (një) pllakashtrues;
- 1 (një) shtrues asfalti;
- 1 (një) elektrikist;
- 1 (një) teknik ndërtimi;
- 1 (një) manovrator (i cili mund të disponohet nga operatori ekonomik edhe nëpërmjet kontraktimit).

Disponimi i punonjësve të kërkuar do të dëshmohet nëpërmjet formularit përmbledhës të vetëdeklarimit. Për dokumentacionin provues zbatohen përcaktimet e nenit 26 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Afati kohor për hapjen e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje ndryshon si më poshtë:

ISHTE:

16/07/2026 Ora: 09:00:

BËHET:

23/07/2025, ora 09:00

Kjo shtojcë, ngarkohet në sistemin e prokurimit elektronik dhe u vihet në dispozicion të gjithë operatorëve ekonomikë të interesuar.

NJËSIA E PROKURIMIT